

L I G J
Nr. 8080, datë.1.3.1996

PËR LETRAT ME VLERË

(Ndryshuar me ligjet; nr. 8168, datë 5.12.1996; nr. 8745, datë 22.2.2001; nr. 9572, datë 3.7.2006)

(i përditësuar)

Në mbështetje të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

Neni 1

Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është krijimi i sigurisë për investitorët e letrave me vlerë nëpërmjet krijimit të një Autoriteti i Letrave me Vlerë, rregullimit të tregut të letrave me vlerë dhe të veprimtarisë së subjekteve që përfshihen në tregtimin e tyre, si dhe nëpërmjet kontrollit të emetimit publik dhe tregimit të letrave me vlerë.

Neni 2

Përkufizime

(Ndryshuar përkufizime dhe shtuar 2 përkufizimet fundit me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Në këtë ligj, përveç rasteve kur konteksti parashikon ndryshe:

“Publikim “, nënkupton çdo formë publiciteti, qoftë në një botim, me anë të vendosjes së shpalljeve, qarkoreve apo dokumenteve të ngjashme, me anë të paraqitjes së fotografive apo filmave kinematografikë, me anë të transmetimeve radiotelevizive, me anë të shpërndarjes së regjistrimeve, apo në tjetër mënyrë;

“Bord”, në lidhje me tregun e letrave me vlerë, nënkupton organin drejtues për kohën e veprimit të këtij tregu;

“Autoriteti”, nënkupton Autoritetin e Letrave me Vlerë të përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji;

“Shoqëri tregtare”, nënkupton një shoqëri aksionare të krijuar në përputhje me ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”;

“Përfaqësues i një tregtari të letrave me vlerë”, nënkupton një individ të punësuar nga një tregtar i licencuar për tregtimin e letrave me vlerë apo që vepron në marrëveshje me të dhe që kryen për tregtarin e letrave me vlerë çdo funksion të tij (me përjashtim të punës që kryhet nga llogaritarët, sekretarët apo arkëtarët). Shpërblimi i përfaqësuesit të tregtarit të letrave me vlerë bëhet me anë të një page, shpërblimi komisioner apo forme tjetër.

“Funksion”, nënkupton autoritet dhe detyrë;

“Përfaqësues i investimeve”, nënkupton një individ të punësuar nga një këshilltar i

licencuar investimesh apo që vepron në marrëveshje me të dhe që kryen për këshilltarin e licencuar të investimeve çdo funksion të tij (me përjashtim të punës që kryhet nga llogaritarët, sekretarët apo arkëtarët). Shpërblimi i përfaqësuesit të investimeve bëhet me anë të një page, shpërblimi komisioner apo forme tjetër.

“Emetues”, nënkupton një subjekt nga i cili janë emetuar apo do të emetohen letra me vlerë;

“Tregtar i licencuar i letrave me vlerë”, nënkupton një shoqëri tregtare e cila është lejuar nga autoriteti përkatës në vend të kryejë një veprimtari në lidhje me letrat me vlerë, qoftë si një agjent për të tjerët, qoftë për vete;

“Këshilltar i licencuar investimesh” mund të jetë një person fizik ose shoqëri tregtare e organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose si shoqëri anonime, i cili është lejuar nga autoriteti përkatës në vend të kryejë një veprimtari lidhur me këshillimin e të tjerëve për letrat me vlerë, përfshi marrëveshjet për blerjet, shitjet ose këmbimin e letrave me vlerë, por nuk përfshin:

i) një bankë të licencuar nga Banka Qendrore;

ii) një tregtar të licencuar apo një përfaqësues të një tregtari të licencuar, këshilla e të cilit mbi investimet, drejtimin e veprimtarisë së tij apo punësimin në tregtimin e letrave me vlerë është vetëm e rastit;

iii) një drejtues investimesh të licencuar;

“Një drejtues investimesh i licencuar”, nënkupton një shoqëri tregtare të licencuar, qoftë në bazë të këtij ligji apo ligjit nr.7979, datë 26.7.1996 “Mbi fondet e investimeve”, për të kryer një veprimtari në administrimin e letrave me vlerë për llogari të të tjerëve;

“Përfaqësues i licencuar”, nënkupton, sipas rastit, një individ i cili është i licencuar të veprojë si përfaqësues i një tregtari apo përfaqësues investimesh;

“I licencuar”, nënkupton një person të licencuar që lejohet të kryejë veprimtari në investimin e letrave me vlerë sipas kërkesave të neneve 29 dhe 30 të kreut 5 të këtij ligji;

“Anëtar”, nënkupton një tregtar të licencuar të letrave me vlerë që është pranuar si anëtar në tregun e letrave me vlerë;

“Rregulla” nënkupton rregullat që drejtojnë veprimtarinë e tregut të letrave me vlerë ose të anëtarëve të tij, me çfarëdo emri që paraqiten dhe kudo që të përfshihen, rregullat e listimit dhe normat e përfshira në statutin e shoqërisë së licensuar, për të vënë në veprim një treg të letrave me vlerë;

“Letra me vlerë” nënkupton:

a) “aksione” si pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare;

b) “letra borxhi” si instrument që krijon ose konfirmon borxhin që është emetuar ose propozohet për t’u emetuar nga një shoqëri që përfshin, në veçanti, letra borxhi me maturim mbi një vit;

c) “letrat me vlerë të qeverisë dhe të borxhit publik” si hua, obligacione dhe instrumente të tjera që krijojnë ose vërtetojnë borxhin e emetuar nga Qeveria Shqiptare ose për të, ose nga një shoqëri publike, si dhe letrat me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë;

ç) “garanci” si e drejta për të nënshkruar aksionet ose letrat me vlerë të borxhit, të paraqitura nga garantues, ose të tjera të ngjashme (warranty);

d) “kontratë mundësie” si çdo kontratë që krijon mundësinë për të zotëruar ose për të vënë në përdorim çdo letër tjetër me vlerë (opcion);

dh) “kontratë e së ardhmes” si e drejtë sipas një kontrate për zotërimin ose vënien në përdorim të ndonjë letre tjetër me vlerë, dorëzimi i së cilës do të bëhet në një datë të ardhshme dhe me një çmim mbi të cilin është rënë dakord në çastin e nënshkrimit të kontratës (futures);

e) të drejtat sipas një kontrate, e cila nuk siguron dorëzimin e letrave me vlerë, por qëllimi i së cilës është të sigurojë fitim ose të shmangë humbjet, duke iu referuar luhatjeve në:

(I) një indeks aksionesh ose faktorë të tjerë të ngjashëm, lidhur me letra të tjera me

vlerë;

(II) çmimin e letrave të tjera me vlerë;

(III) përqindjen e interesit të ofruar për paratë në depozita;

ë) çdo instrument tjetër që gjykohet nga Autoriteti për qëllimet e këtij ligji, si letër me vlerë, por nuk përfshin:

(I) kambialet;

(II) bonot e thesarit me një maturim fillestar më pak se tre muaj;

(III) premtim-pagesat;

(IV) certifikatat e depozitave të emetuara nga një bankë e licensuar nga Banka e Shqipërisë;

“Tregu i letrave me vlerë”, nënkupton një bursë kapitali apo të letrave me vlerë apo ndonjë treg tjetër, një sistem apo vend tregtimi, me anë të të cilit:

a) ofertat për shitje, blerje apo këmbim të letrave me vlerë kryhen dhe pranohen rregullisht;

b) ofertat apo kërkesat kryhen rregullisht, kur janë oferta apo kërkesa të paracaktuara, apo janë të pritshme, që rezultojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në bërjen apo pranimin e ofertave për shitje, blerje apo këmbim të letrave me vlerë; ose

c) jepet informacion rregullisht lidhur me çmimet dhe shpërblimet që persona ose grupe të veçanta propozojnë, apo presin, të shesin, të blejnë apo të këmbejnë letrat me vlerë;

“Nënshkrimi” nënkupton blerjen e letrave me vlerë të emetuara rishtazi, me qëllim rishitjen publike në emër të emetuesit ose garancinë për një emetues, që pjesa e pashitur e emetimit ose e shitjes publike të letrave me vlerë të emetuesit do të mbulohet nga nënshkruesi.

“Depozitar” nënkupton një institucion financiar që ruan pasurinë e pjesëmarrësve të tregut të letrave me vlerë për llogari të investitorëve.

“Prospekt” nënkupton një dokument të shtypur, i hartuar nga emetuesi i letrave me vlerë dhe i miratuar nga Autoriteti i cili përshkruan tiparet kryesore të veprimtarisë dhe që u shpërndahet investitorëve të ardhshëm si informacion i domosdoshëm për vendimmarrjen e tyre, sipas të gjitha rregullave të vendosura nga Autoriteti.

KREU II

AUTORITETI I LETRAVE ME VLERË

(Shfuqizuar Kreu II, Nenet 3 – 16 me ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006)

KREU III

ORGANIZIMI I TREGUT TË LETRAVE ME VLERË

Neni 17

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Neni 18

(Shfuqizuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Neni 19

Bordi mbikëqyrës i tregut të letrave me vlerë

(Ndryshuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Tregu i letrave me vlerë ka Bordin Mbikëqyrës të tij, i cili miratohet nga Autoriteti dhe funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Neni 20
(Ndryshuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Bordi Mbikëqyrës i tregut të letrave me vlerë, i krijuar sipas nenit 11 të këtij ligji, përbëhet nga të paktën 5 anëtarë.

2. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës duhet të jenë me reputacion të mirë, të zotërojnë arsimin e lartë përkatës dhe të kenë përvojë profesionale në fushën bankare dhe në veprimtarinë tregtare.

3. Bordi Mbikëqyrës për ushtrimin e veprimtarisë së tij harton rregulloren “Për funksionimin e Bordit Mbikëqyrës të tregut të letrave me vlerë”, e cila miratohet nga Autoriteti.

4. Bordi vendos rregulla të tilla, që ai i vlerëson të nevojshme dhe të dëshirueshme për të pasur frytshmëri në rregullimin, veprimtarinë, drejtimin dhe kontrollin e tregut të letrave me vlerë, të cilat i bëhen të njohura paraprakisht Autoritetit.

5. Kur Bordi Mbikëqyrës gjykon se është e nevojshme të bëhen ndryshime në rregulloret e tij, i paraqet Autoritetit për miratim një projekt me ndryshimet e propozuara.

6. Autoriteti, brenda 14 ditëve miraton ose kundërshton me shkrim pjesërisht ose plotësisht të gjitha ndryshimet e propozuara. Ndryshimet e propozuara dhe të pranuar sipas këtij paragrafi hyjnë në fuqi nga data e pranimit të tyre. Nëse ndryshimet e propozuara nuk kundërshtohen brenda 14 ditëve, miratimi do të konsiderohet i dhënë dhe efektet e tij juridike fillojnë në datën kur mbaron afati 14-ditor.

Neni 21
(Ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Për përmbushjen e detyrës së mbrojtjes së investitorëve apo për rregullimin e duhur të tregut të letrave me vlerë, Autoriteti mund të udhëzojë tregun e letrave me vlerë:

a) lidhur me tregtimin nëpërmjet pajisjeve apo sistemeve të tregut të letrave me vlerë ose lidhur me tregtimin e një letre të caktuar me vlerë në treg;

b) lidhur me mënyrën apo ndonjë aspekt të veprimtarisë së tregut, pëfshirë këtu mënyrën e raportimit të tregimit jashtë sferës së veprimtarisë së tregut nga anëtarët; ose

c) lidhur me çdo çështje tjetër që Banka e Shqipërisë e konsideron të nevojshme për administrimin efektiv të këtij ligji.

Neni 22
Autoriteti i Autoritetit për të kërkuar amendamente të rregullave
(Ndryshuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Kur Autoriteti e gjykon të nevojshme për mbrojtjen e investitorëve, mund t’i kërkojë me shkrim Bordit Mbikëqyrës të bëjë ose të ndryshojë një ose disa rregulla. Autoriteti duhet të specifikojë amendamentet dhe datën kur do të hyjnë në fuqi ndryshimet e tyre. Bordi Mbikëqyrës vepron në përputhje me këtë kërkesë sa më shpejt të jetë e mundur, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti.

Neni 23
(Ndryshuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Bordi i ofron asistencë Autoritetit kur ai e kërkon një gjë të tillë, për qëllim të kryerjes së funksioneve të tij, duke i dhënë njoftim lidhur me tregtimin e letrave me vlerë ose të dhënë tjetër të veçantë që Autoriteti mund të kërkojë për administrimin e duhur të këtij ligji.

KAPITULLI IV
VEPRIMTARIA NË TREGUN E LETRAVE ME VLERË

Neni 24

Krijimi i tregut të letrave me vlerë
(Ndryshuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Tregjet e letrave me vlerë licensohen nga Autoriteti në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 25

Kërkesa për licencën e tregut të letrave me vlerë

1. Vetëm një shoqëri tregtare mund t'i bëjë kërkesë Autoritetit për të marrë licencë për funksionimin e një tregu të letrave me vlerë.

2. Sipas pikës 1 të këtij neni, kërkesë për licencë bëhet në një formë të caktuar dhe shoqërohet nga kuota përkatëse.

Neni 26

Dhënia e licencës për tregun e letrave me vlerë

1. Në bazë të kërkesës për licencë të marrë sipas nenit 25 të këtij ligji, Autoriteti mund të japë licencën në qoftë se plotësohen këto kushte:

- a) dhënia e licencës i shërben interesave të publikut; dhe
- b) kërkuksi i licencës plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

2. Kushtet që duhet të plotësojë kërkuksi i licencës janë:

a) objektivat e statutit të kërkuksit të licencës duhet të përfshijnë krijimin dhe veprimtarinë e një tregu të letrave me vlerë;

b) kërkuksi i licencës mund të sigurojë dhe mirëmbajë pajisjet e nevojshme dhe të përshtatshme apo sistemet e drejtimit të punës në tregun e letrave me vlerë;

c) kërkuksi i licencës duhet të ketë jo më pak se 3 anëtarë të cilët merren me shpërndarjen e letrave me vlerë në mënyrë të pavarur dhe në konkurrencë me njëri-tjetrin;

ç) rregullat dhe procedurat që duhet të ndjekë kërkuksi i licencës duhet të jenë të tilla që të sigurojnë funksionimin e rregullt të pajisjeve apo sistemeve të tij si dhe t'u japë investitorëve sigurinë e duhur;

d) kërkuksi i licencës ka bërë marrëveshje të tilla që Autoriteti i gjykon të kënaqshme për:

i) pastrimin dhe rregullimin e llogarive në tregtimin e letrave me vlerë për të siguruar kryerjen e transaksioneve në tregun e letrave me vlerë, si dhe për regjistrimin e publikimin e këtyre transaksioneve;

ii) mbikëqyrjen e tregut;

iii) evidentimin efektiv dhe përputhjen e rregullave të tij me këtë ligj, si dhe me rregullat e vendosura në bazë të këtij ligji; dhe

iv) shqyrtimin e ankesave të bëra nga anëtarët e tij lidhur me veprimtarinë në letrat me vlerë.

Neni 27

Tërheqja e licencës për tregun e letrave me vlerë

Autoriteti mund të tërheqë një licencë për tregun e letrave me vlerë dhënë një shoqërie, në bazë të nenit 26 të këtij ligji, në qoftë se:

- a) shoqëria ndalon veprimtarinë në tregun e letrave me vlerë;
- b) shoqëria është shpallur në gjendje falimentimi nga gjykata; ose
- c) shoqëria vepron në kundërshtim me interesin publik.

Neni 28

Autoriteti disiplinor i Autoritetit

(Ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Përpara se Autoriteti të qortojë, të gjojë, të pezullojë, të përjashtojë apo të ndërmarrë veprime disiplinore ndaj një anëtarit të tregut të letrave me vlerë, Bordi duhet që brenda shtatë ditësh t'i japë Autoritetit me shkrim të dhëna mbi emrin dhe natyrën e veprimit që propozohet të ndërmerret.

2. Pas marrjes së njoftimit me shkrim, Autoriteti, pavarësisht nga propozimi i bërë nga bordi, ka të drejtë të marrë çdo vendim në lidhje me masat që duhen marrë për të licensuarin.

KREU V

LICENCIMI I AGJENTËVE NË INVESTIMIN E LETRAVE ME VLERË

Neni 29

Licencimi

(Ndryshuar shkronja “d” e pikës 2 me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Askush nuk mund të ndërmarrë një veprimtari lidhur me investimin në letrat me vlerë në qoftë se nuk është i licensuar nga Autoriteti sipas këtij kreu.

2. Në këtë ligj, “Veprimtari lidhur me investime në letrat me vlerë”, nënkuptohet ndërmarrja e njërit prej veprimeve të mëposhtme:

a) blerja, shitja, nënshkrimi i letrave me vlerë apo një ofertë që pranon të bëjë një nga këto veprime, qoftë për vete, qoftë si agjent;

b) administrimi apo oferta për të administruar letra me vlerë të tjerëve, qoftë apo jo drejtues investimesh;

c) dhënia apo ofrimi i këshillave investitorëve apo investitorëve të mundshëm lidhur me blerjen, shitjen, nënshkrimin apo kërkesën për letra me vlerë;

ç) ofrimi i shërbimeve për pastrimin e llogarive dhe rregullimin e transaksioneve në letrat me vlerë;

d) ofrimi i shërbimeve depozituese i letrave me vlerë, si dhe ofrimi i shërbimeve për regjistrimin e letrave me vlerë; dhe

dh) çdo veprimtari tjetër që Autoriteti e gjykon si investim në letra me vlerë për qëllim të këtij ligji.

Neni 30

Kërkesa për licencë

1. Sipas këtij kreu, kërkesa për licencë i bëhet Autoritetit në një formë dhe mënyrë të përcaktuar nga Autoriteti i Letrave me Vlerë dhe shoqërohet nga kuota përkatëse.

2. Kërkesa duhet të specifikojë llojin e letrave me vlerë me të cilat do të operohet si dhe shërbimet për të cilat ai e gjykon veten të aftë për të zhvilluar këtë veprimtari.

3. Autoriteti mund t'i kërkojë një kërkuar të licencës informacion plotësues, kur e gjykon të nevojshme.

Neni 31

Dhënia e licencës së tregtimit, investimit apo këshillimit

(Ndryshuar përqindja në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 7 me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Licenca e tregtimit dhe licenca e investimit do t'i jepen vetëm asaj shoqërie aksionare e cila me kohë do të punësojë të paktën një person që ka licencë përfaqësimi si tregtar, sipas këtij kreu.

2. Autoriteti mund ta japë ose ta refuzojë një kërkesë për licencë të kryer sipas nenit 30 të këtij ligji.

3. Autoriteti e jep licencën në rastet kur ai e gjykon se kërkuesi i licencës i përmbush kushtet për të zhvilluar veprimtari në investimet në letrat me vlerë dhe se ai ofron të gjitha shërbimet që përshkruhen në kërkesën për licencë, përndryshe Autoriteti e refuzon licencën.

4. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për licencë, Autoriteti, nëse kërkuesi i licencës është një person fizik, apo një shoqëri tregtare, duhet të mbajë parasysh për personin fizik apo anëtarët e organeve drejtuese të shoqërisë këto kushte:

a) gjendjen financiare;

b) përshtatshmërinë që ekziston midis arsimimit, kualifikimit dhe përvojës së tij me llojin e kërkesës për licencë;

c) aftësitë për të përmbushur detyrat e propozuara në mënyrë eficiente, të ndershme dhe të drejtë; dhe

ç) reputacionin, karakterin, integritetin financiar dhe besueshmërinë e tij.

5. Për qëllime të këtij neni, Autoriteti mund të marrë parasysh çdo informacion tjetër që zotëron, pavarësisht nëse burimi i informacionit është kërkuesi i licencës ose jo.

6. Për qëllim të pikës 3 të këtij neni, Autoriteti mund të marrë parasysh çështjet që lidhen me:

a) një person i cili është ose do të jetë i punësuar apo bashkëpunon me kërkuesin e licencës për qëllim të kryerjes së veprimtarisë me të cilën është i lidhur kërkuesi i licencës;

b) një person që është i punësuar ose do të punësohet apo që shoqërohet me kërkuesin e licencës për qëllim të kryerjes së veprimtarisë me të cilën ka lidhje kërkesa për licencë;

c) kërkuesin e licencës, në rast se ai është një shoqëri tregtare, aksionar kryesor, drejtor apo zyrtar i shoqërisë tregtare.

7. Në pikën 6 të këtij neni, "Aksionar kryesor" në lidhje me një shoqëri tregtare, nënkupton një person i cili zotëron një pjesë të aksioneve në një ndërmarrje:

a) vlera nominale e së cilës është e barabartë ose më e madhe se 10 për qind e kapitalit aksionar të emetuar të shoqërisë tregtare; ose

b) e cila i jep të drejtën personit të ushtrojë apo kontrollojë 10 për qind ose më shumë të votave në ndonjë asamble të përgjithshme të shoqërisë tregtare.

Neni 32

Dhënia e licencës së përfaqësuesit

1. Licenca e përfaqësimit i jepet vetëm individit, dhe në rastin e një shoqërie tregtare, vetëm personit i cili ka mandatin për të përfaqësuar shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.

2. Autoriteti do të japë një licencë përfaqësimi si tregtar apo licencë përfaqësimi investimi, nëse, pas shqyrtimit të kërkesës, ai nuk gjen shkak të besojë se kërkuesi i licencës nuk do të përmbushë detyrat e zotëruesit të licencës së përfaqësimit efektivisht dhe me ndershmëri; në të kundërt, Autoriteti refuzon dhënien e licencës.

Neni 33

Autoriteti i Autoritetit për vendosjen e kufizimeve

1. Autoriteti mund të japë një licencë, e cila do të jetë subjekt i kushteve dhe kufizimeve që Autoriteti i gjykon të përshtatshme. Në çdo kohë, nëpërmjet një njoftimi me shkrim që i dërgohet personit të licencuar, Autoriteti mund të ndryshojë ndonjë kusht apo kufizim për kohën që licenca është e vlefshme, apo të vendosë ndonjë kusht ose kufizim të mëtejshëm.

2. Autoriteti mund të kërkojë si kusht për licencimin e një personi, si përfaqësues apo drejtues dhe në vazhdimësi të një licencimi të tillë, që ai të kalojë disa provime të administruara apo nën mbikëqyrjen e Autoritetit në përputhje me normat e ligjit të letrave me vlerë, rregullat e Autoritetit dhe të Shoqërisë së Letrave me Vlerë të paraqitura në nenin 4 të këtij ligji dhe praktika e veprimtarisë së lirë në tregun e letrave me vlerë.

Neni 34

Revokimi dhe pezullimi i licencave

1. Autoriteti mund të revokojë licencën e dhënë një personi sipas këtij kreu, nëse individi:

a) është i paaftë mendërisht apo fizikisht, e konfirmuar kjo nga raportet mjekësore, për të kryer veprimtaritë me të cilat ka të bëjë licenca;

b) ka falimentuar një herë në Shqipëri apo diku tjetër;

c) është dënuar për krime në ekonomi si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj, për mashtrim, falsifikim si dhe për vepra penale të tjera të cilat parashikojnë një dënim me heqje lirie për mbi dhjetë vjet;

ç) është shpallur fajtor për shkelje të këtij ligji apo ndonjë rregull të këtij ligji;

d) shkel apo nuk përmbush ndonjë kusht apo kufizim të zbatueshëm lidhur me licencën;

dh) ndërpret veprimtarinë për të cilën ka marrë licencë;

e) zotëron një licencë përfaqësimi dhe licenca e tregtarit apo këshilltarit të investimeve të cilin ai përfaqëson i është revokuar apo pezulluar; ose

2. Autoriteti mund të revokojë licencën e dhënë një shoqërie tregtare sipas këtij kreu nëse:

a) shoqëria tregtare likujdohet apo është urdhëruar të mbyllet;

b) emërohet një marrës apo drejtues i pasurisë së shoqërisë tregtare;

c) shoqëria tregtare ndërpret veprimtarinë për të cilën ajo është licencuar;

ç) Autoriteti ka arsye për të besuar se shoqëria tregtare, apo ndonjë drejtues ose punonjës i saj, nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre me efektivitet dhe ndershmëri;

d) shoqëria tregtare shkel apo nuk përmbush ndonjë kusht apo kufizim që zbatohet në lidhje me licencën;

dh) shoqëria tregtare shkel një rregull të këtij ligji;

e) shoqëria tregtare nuk punëson të paktën një person i cili ka licencën e përfaqësimit të dhënë sipas këtij kreu.

3. Autoriteti, nëse e shikon të përshtatshme, mundet që në vend të revokimit të licencës, ta pezullojë atë për një periudhë të caktuar, ose derisa të ndodhë një ngjarje e caktuar, siç mund ta përcaktojë ai.

4. Autoriteti mund të revokojë licencën me kërkesën e të licencuarit.

5. Një personi, të cilit i është revokuar apo pezulluar licenca sipas këtij neni, do të gjykohet si i palicencuar që nga data që Autoriteti i revokon apo i pezullon licencën.

6. Pezullimi apo revokimi i një licence sipas këtij neni nuk vepron si i tillë kur:

a) shmang apo ndikon në ndonjë marrëveshje, transaksion apo rregullim që ka të bëjë

me tregtimin e letrave me vlerë të realizuara nga personi të cilit i është pezulluar apo revokuar licenca, pavarësisht nëse marrëveshja, transaksioni apo rregullimi është kryer para apo pas pezullimit apo revokimit të licencës; ose

b) ndikon në ndonjë të drejtë, përgjegjësi apo detyrim që del nga një marrëveshje, transaksion apo rregullim i tillë.

Neni 35

Autoriteti nuk ka të drejtë:

a) të refuzojë dhënien e një licence; ose

b) të revokojë apo pezullojë një licencë; po qe se ai nuk e njofton, sipas rastit, kërkuesin e licencës apo të licencuarin, lidhur me qëllimin dhe arsyet përse është vendosur kështu, duke i dhënë atij mundësinë e dëgjimit.

Neni 36

Regjistri i të licencuarve

(Hequr fjali në pikën 1 me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Autoriteti do të mbajë një regjistër të personave që janë pajisur me licenca sipas këtij kreu.

2. Për çdo tregtar të licencuar, drejtues investimesh apo këshilltar investimesh, në regjistër do të shënohen:

a) emri i të licencuarit;

b) data në të cilën është dhënë licenca;

c) emri i secilit drejtues dhe sekretari të shoqërisë tregtare, në rastin e një licence tregtari apo drejtuesi investimesh, ose në rastin e një licence për këshilltar investimesh që i jepet një shoqërie tregtare, si dhe emrat dhe pronësitë e aksioneve të secilit aksionar; dhe

ç) materiale të tjera, siç mund të përcaktohen.

3. Për çdo përfaqësues të licencuar, në regjistër do të shënohen:

a) emri i personit të licencuar dhe data e dhënies së licencës;

b) emri dhe adresa e zyrës së punës së tregtarit apo këshilltarit të investimeve në lidhje me të cilin ai është licencuar; dhe

c) materiale të tjera, siç mund të përcaktohen.

4. Regjistri që do të mbahet sipas pikës 1 të këtij neni, do të qëndrojë i hapur për t'u inspektuar falas nga publiku gjatë orarit të zakonshëm zyrtar.

Neni 37

Njoftimi për ndryshime

(Hequr togfjalësh në pikën 2 me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Çdo subjekt i licencuar, në të gjithë rastet e përmendura në vijim të këtij neni, duhet që brenda 14 ditëve të paraqesë me shkrim te Autoriteti, në një formë të përcaktuar, problemet kryesore dhe hollësitë që kanë të bëjnë me ngjarjen në fjalë.

Kur:

a) një tregtar i licencuar, drejtues investimesh ose këshilltar investimesh ndërpret veprimtarinë për të cilën i është dhënë licenca;

b) një përfaqësues i licencuar pushon së qeni përfaqësues për tregtarin apo këshilltarin e investimeve në lidhje me të cilin ishte dhënë licenca e përfaqësimit; apo

c) ndodh ndonjë ndryshim në ndonjë material të veçantë, i cili kërkohet nga neni 36 i këtij ligji për t'u regjistruar në regjistrin e licencave,

2. Në bazë të këtij ligji, mund t'i kërkohej të licencuarit që t'i japë Autoritetit informacion shtesë nëpërmjet raporteve periodike apo diçkaje tjetër.

KREU VI OFERTAT PUBLIKE TË LETRAVE ME VLERË TË VEÇANTË

Neni 38

Ofertat e aksioneve, të letrave të borxhit dhe garancive

(Ndryshuar titulli, fjalë në pikën 1, togfjalësh në pikën 3, pika 4 me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Ky kre zbatohet vetëm për letrat me vlerë të tilla si: aksionet, letrat e borxhit apo garancitë.

2. Në kuptim të këtij kreu, një person thuhet se ofron letra me vlerë, nëse ai fton dikë tjetër për të lidhur një marrëveshje me qëllim nënshkrimin apo zotërimin e ndonjë letre me vlerë, ose kur ai fton një person tjetër të kryejë një ofertë të tillë.

3. Një ofertë letrash me vlerë quhet publike kur ajo i bëhet më shumë se 50 personave.

4. Publikimi, i ndryshëm nga prospekti, i cili shpall një ofertë publike të letrave me vlerë, për të cilën sipas këtij kreu kërkohej një prospekt, nuk do t'i paraqitet publikut në Republikën e Shqipërisë, në qoftë se publikimi nuk përcakton se është publikuar më parë një prospekt dhe nuk jep një adresë në Republikën e Shqipërisë nga ku mund të sigurohet ky publikim.

Neni 39

Publikimi dhe regjistrimi i prospektit

(Ndryshuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Kur në Republikën e Shqipërisë bëhet një ofertë publike letrash me vlerë, ofruesi do të publikojë një prospekt, i cili do të jetë në dispozicion të publikut falas dhe në një adresë të caktuar në Republikën e Shqipërisë, gjatë gjithë periudhës së kohës që oferta e letrave me vlerë qëndron e hapur.

2. Ofruesi duhet, jo më pak se 21 ditë përpara publikimit të prospektit, të dorëzojë një kopje të tij për regjistrim pranë Autoritetit.

3. Nuk mund të publikojë një prospekt një person i paregjistruar nga Autoriteti.

4. Nëse një person që bën një ofertë publike ka publikuar një prospekt brenda 12 muajve në vijim nga data kur oferta është bërë për herë të parë, mund të publikojë një prospekt vetëm për diferencat që rezultojnë që nga publikimi i prospektit të mëparshëm dhe që ka mundësi të ndikojë në vlerën e letrave me vlerë, me kusht që prospekti i ri të shoqërohet edhe me një kopje të atij të mëparshmit.

Neni 40

Përmbajtja e prospektit

(Ndryshuar fjalë në titull, në pikën 1, shkronja "a" nëndarjet i), ii) dhe në shkonjën "b" me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Autoriteti regjistron një prospekt vetëm nëse:

a) prospekti përmban në mënyrë të plotë informacionin që investorët dhe këshilltarët profesionalë të tyre do të kërkonin dhe do të shpresonin të gjenin në të, në mënyrë që të bënin një vlerësim korrekt mbi:

i) aktivet dhe pasivet, pozitën financiare, fitimet dhe humbjet si dhe prospektet e

emetuesit të letrave me vlerë; dhe

ii) të drejtat që kanë të bëjnë me këto letra me vlerë;

b) prospekti përmban, gjithashtu, informacion dhe të dhëna shtesë, si dhe përmbush disa kërkesa dhe norma të tjera, ashtu siç mund të përcaktohen ato nga Autoriteti.

Neni 41

Dëmshpërblimi për prospektet false apo mashtruese

(Ndryshuar fjalë në titull dhe në përmbajtje me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Çdo drejtues i një emetuesi, apo ndonjë person tjetër i cili është përgjegjës për prospektin, është i detyruar të dëmshpërblejë personin i cili zotëron ndonjë letër me vlerë që lidhet me këtë prospekt, nga e cila ai ka pësuar humbje si pasojë e një deklarate jo të vërtetë dhe mashtruese në prospekt, apo nga harresa e ndonjë të dhëne, e cila sipas nenit 40 të këtij ligji, duhet të përfshihet në prospekt.

Neni 42

Detyrimi për informim të vazhdueshëm

(Hequr togfjalësh në pikën 1, ndryshuar togfjalësh në pikën 2 me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Çdo emetues i letrave me vlerë që është subjekt i një oferte publike, ose që zotërohen publikisht, do të informojë Autoritetin, anëtarët e emetuesit si dhe zotëruesit e tjerë të letrave me vlerë të tij mbi ato të dhëna, nëse ka, që lidhen me emetuesin apo filialet e tij, të cilat:

a) janë të nevojshme për to dhe për publikun për të vlerësuar pozitën financiare të emetuesit dhe filialeve të tij;

b) janë të nevojshme për të shmangur krijimin e një tregu fals për letrat me vlerë të tij; ose

c) që kanë shumë mundësi të ndikojnë dukshëm veprimtarinë e tregut në drejtim të çmimeve të letrave me vlerë të tij.

2. Në kuptim të këtij neni, letrat me vlerë quhen të zotëruara publikisht, nëse emetuesi ka më shumë se 50 zotërues të letrave me vlerë të tij, pavarësisht se kur janë emetuar këto letra me vlerë.

3. Përveç kërkesave të pikës 1 të këtij neni, emetuesi duhet të përmbushë detyrime dhe kërkesa të mëtejshme, ashtu siç mund të përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, pas konsultimeve me Autoritetin.

KREU VII

ETIKA E VEPRIMTARISË SË INVESTIMIT NË LETRAT ME VLERË

(Ndryshuar titulli i Kreut me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Neni 43

Parimet kryesore

(Ndryshuar fjalë në paragrafin e parë, hequr togfjalësh në paragrafin "h" me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Gjatë veprimtarisë së investimit në letrat me vlerë, subjekti i licencuar gjatë gjithë kohës do të veprojë mbi bazën e parimeve të praktikës më të mirë, dhe në veçanti:

a) realizon një standard të lartë integrimi dhe tregtimi të ndershëm;

b) vepron me një shkallë të lartë aftësie dhe kujdesi;

c) realizon standarde të larta të drejtimit të tregut;

ç) kërkon nga klientët informacion mbi rrethanat dhe objektivat e tyre të investimit, të cilat mund të jenë shumë të vlefshme dhe i japin mundësi të licencuarit që të përmbushë detyrimet e tij kundrejt klientëve;

d) ndërmerr hapa të kujdesshëm për t'u dhënë klientëve, në mënyrë të qartë, ndonjë informacion të nevojshëm, ashtu siç këshillon i licencuari, në mënyrë që ata të marrin një vendim të drejtë dhe korrekt investimi;

dh) shmang ndonjë konflikt interesash me klientët, dhe nëse një konflikt i tillë shfaqet në mënyrë të pashmangshme, t'i sigurojë një trajtim të drejtë klientit nëpërmjet një informimi të plotë apo një mosveprimi; për më tepër, interesat e të licencuarit nuk duhet të vihen në mënyrë të pandershme mbi ato të klientëve;

e) mbron siç duhet, nëpërmjet veçimit dhe identifikimit, ato mjete të klientëve, për të cilat i licencuari është drejtpërdrejt përgjegjës;

ë) mban burime të mjaftueshme financiare për të përmbushur përgjegjësitë dhe premtimet në veprimtarinë e letrave me vlerë dhe përballon rrezikun që e shoqëron veprimtarinë përkatëse;

f) organizon dhe kontrollon punët e brendshme në mënyrë të përgjegjshme;

g) mban regjistrimet e duhura;

gj) bën rregullimet dhe sistemimet e duhura me qëllim që i gjithë stafi të jetë i përshtatshëm, i specializuar dhe i mbikëqyrur siç duhet, së bashku me një procedurë kontraktimi të përcaktuar mirë; dhe

h) vepron në lidhje me Autoritetin me një frymë të hapur dhe bashkëpunimi, si dhe informon Autoritetin për çdo gjë që ka të bëjë me të licencuarin dhe që duhet t'i bëhet e ditur atij.

Neni 44

Rregullat e Etikës

(Ndryshuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Këshilli i Ministrave, pas këshillimeve me Autoritetin, mund të përcaktojë rregulla për etikën e veprimtarisë së investimit në letrat me vlerë nga subjektet e licencuara.

2. Kur ndonjë kontratë për shitjen apo blerjen e letrave me vlerë është në kundërshtim dhe shkel rregullat e etikës, të përcaktuara sipas këtij neni, shkelja është objekt padie civile nga personi i cili ka pësuar humbje prej një shkeljeje të tillë.

Neni 45

Nxjerrja e deklaratave për kontratat

1. Një tregtar i licencuar, për çdo kontratë lidhur me blerjen, shitjen apo këmbimin e letrave me vlerë të kontraktuara nga ai, qoftë si person kryesor apo si agjent, jo më vonë se fundi i ditës tjetër të tregtimit, pasi është nënshkruar kontrata, harton një deklaratë për kontratën, e cila duhet të jetë në përputhje me pikën 2 të këtij neni, dhe:

a) nëse kontrata nënshkruhet nga tregtari si agjent, të dorëzojë deklaratën origjinale për kontratën te personi në emër të të cilit ai ka kontraktuar; ose

b) nëse kontrata nënshkruhet nga tregtari si person kryesor, të mbajë për vete deklaratën për kontratën.

2. Deklarata për kontratën do të përmbajë:

a) emrin apo markën tregtare nën të cilën tregtari drejton veprimtarinë si tregtar, si dhe adresën e zyrës kryesore në të cilën ai drejton veprimtarinë;

b) nëse tregtari vepron si person kryesor, një deklaratë që tregon se ai vepron si i tillë;

c) emrin dhe adresën e personit, nëse ka, të cilit tregtari duhet t'ia japë deklaratën për

kontratën dhe, nëse ai është i ndryshëm, emrin e personit për të cilin kryhen transaksionet;

- ç) datën e kontratës, si dhe datën në të cilën hartohet deklarata për kontratën;
- d) sasinë dhe përshkrimin e letrës me vlerë, subjekt i kontratës;
- dh) çmimin për copë të letrave me vlerë;
- e) shumën e shpërblimit të pagueshëm sipas kontratës, ose në rastin e një këmbimi, të dhëna të mjaftueshme mbi letrat me vlerë të këmbjera, me qëllim identifikimin e tyre;
- ë) normën apo shumën e Autoritetit që paguhet në lidhje me kontratën;
- f) shumën e pullës së taksës, nëse ka, të pagueshme në lidhje me kontratën, dhe nëse është e zbatueshme, edhe në lidhje me transferimin;
- g) datën e kontabilizimit;
- gj) informacione të tjera, ashtu siç përcaktohet, për t'u siguruar se do të kryhet një kontroll i plotë mbi ekzekutimin e instruksioneve të klientit dhe kontabilizimin e transaksioneve të tregut.

Neni 46

Llogaritë që do të mbahen nga tregtarët dhe drejtuesit e licencuar të investimeve

1. Tregtari apo drejtuesi i licencuar i investimeve, mban ato veprime kontabël dhe regjistrime të tjera, të cilat në mënyrë të mjaftueshme shpjegojnë transaksionet dhe pozitën financiare të të gjithë veprimtarisë lidhur me licencën dhe që mundësojnë fitime të drejta dhe të vërteta. Gjithashtu, ai mban edhe llogaritë e humbjeve dhe bilancet që duhet të përgatiten kohe pas kohe. Këto regjistrime i mban në mënyrë dhe formë të tillë që ato të kontrollohen me saktësi dhe siç duhet.

2. Pa kufizuar parimet kryesore të pikës 1 të këtij neni, i licencuari do të mbajë ato veprime kontabël dhe regjistrime të tjera, si dhe do të arkivojë ato deklarata dhe raporte financiare, ashtu siç përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, pas konsultimeve me Autoritetin.

Neni 47

Pronësia e klientëve

1. Autoriteti përcakton rregulla lidhur me veçimin dhe ruajtjen e parave apo letrave me vlerë të klientëve, të cilat i licencuari i mban në emër të tyre.

2. Pa kufizuar parimet kryesore të pikës 1 të këtij neni, rregullat e vendosura nga Autoriteti mund:

- a) të kërkojnë që paratë e klientëve të paguhen menjëherë në një llogari bankare, e cila duhet të përmbajë fjalën “klient”;

- b) të përcaktojë kushte lidhur me hapjen dhe mbajtjen e llogarive të klientëve, që kanë të bëjnë me rrethanat në të cilat mund të paguhen në ose nga këto llogari paratë që janë të ndryshme nga ato të klientëve, si dhe ato kushte që kanë të bëjnë me rrethanat në të cilat personave, mund t'u paguhen paratë e mbajtura në këto llogari;

- c) të kërkojnë mbajtjen e llogarive dhe regjistrimeve lidhur me paratë apo letrat me vlerë të klientëve; dhe

- ç) të kërkojnë shqyrtimin e llogarive dhe regjistrimeve nga një kontabilist publik i licencuar dhe t'i kërkojnë këtij kontabilisti që t'i raportojë Autoritetit nëse, sipas tij, janë përmbushur kushtet e këtyre rregullave, si dhe ato që lidhen me çështje të tjera, ashtu siç mund të përcaktohet në këto rregulla të vendosura nga Autoriteti.

3. Paratë apo pronësi të tjera të mbajtura nga i licesuari për llogari të një klienti, nuk do të përdoren për shlyerjen e borxheve të të licencuarit ose të detyrimeve për t'u paguar apo për të zbatuar vendimin e ndonjë gjykate.

Neni 48
Publikimet
(Ndryshuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Këshilli i Ministrave, pas këshillimeve me Autoritetin, mund të përcaktojë rregulla që kanë të bëjnë me formën dhe përmbajtjen e publikimeve për veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë dhe mund të vendosë kufizime mbi personat që bëjnë këto publikime.

KREU VIII
PRAKTIKAT E PALIGJSHME TË TREGTIMIT

Neni 49
Tregtimi i paligjshëm
(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Tregtimi, këshillimi ose caktimi i një personi tjetër për të tregtuar letrat me vlerë të një shoqërie tregtare, duke shfrytëzuar për qëllime përfitimi të dhëna të siguruara nga burime të brendshme që ndikojnë në çmimin e letrave me vlerë, përbëjnë tregtim me të dhëna të brendshme dhe dënohen me gjobë ose me heqje lirie deri në 3 vjet.

2. Ky nen është i zbatueshëm mbi:

- a) drejtuesit, zyrtarët apo punonjësit e shoqërisë tregtare në fjalë;
- b) personin e lidhur në një funksion profesional me atë shoqëri tregtare; dhe
- c) personin i cili siguron një informacion të tillë prej ndonjërit nga personat e përmendur në paragrafët me shkronjat (a) ose (b) të pikës 2 të këtij neni.

3. Asnjë tregtim nuk anulohet apo do të jetë subjekt anulimi, vetëm sepse është në kundërshtim me këtë nen.

Neni 50
Tregtimi fals dhe manipulimi i tregut

1. Asnjë person nuk lejohet të krijojë, të shkaktojë ose të bëjë diçka me qëllim krijimin:

- a) e një paraqitjeje false apo mashtruese lidhur me vëllimin e tregtimit të ndonjë letre me vlerë apo treg letrash me vlerë; ose
- b) e një paraqitje false apo mashtruese të tregut për, ose lidhur me çmimin e një letre të tillë me vlerë.

2. Asnjë person nuk lejohet, nëpërmjet blerjes apo shitjes së ndonjë letre me vlerë që nuk ka të bëjë me ndryshimin në pronësinë e këtyre letrave me vlerë, apo nëpërmjet një transaksioni fiktiv ose mashtrimi, të mbajë, të qarkullojë, të shprehë apo të shkaktojë luhajtje në çmimin e tregut të ndonjë letre me vlerë.

3. Në kuptim të pikës 2 të këtij neni, blerja apo shitja e letrave me vlerë nuk përbën ndryshim në pronësi, nëse personi, apo personi i shoqëruar me këtë person, që ka patur në zotërim një pjesë të këtyre letrave me vlerë përpara blerjes apo shitjes së tyre, zotëron përsëri një pjesë të këtyre letrave me vlerë edhe pas blerjes ose shitjes së tyre.

Neni 51
Përdorimi i deklaratave false si stimuj

Asnjë person nuk lejohet të stimulojë apo të përpiqet të stimulojë një person tjetër, për të tregtuar letra me vlerë:

- a) nëpërmjet hartimit apo publikimit të ndonjë deklarate, premtimi apo parashikimi për të cilin ai është i ndërgjegjshëm se është fals apo mashtrues;
- b) nëpërmjet fshehjes së ndonjë fakti të rëndësishëm, apo
- c) nëpërmjet hartimit apo publikimit të ndonjë deklarate, premtimi apo parashikimi të papërgjegjshëm, që është fals dhe mashtrues.

Neni 52

Transaksionet mashtruese

Asnjë person, qoftë lidhur drejtpërdrejt apo tërthorazi me ndonjë transaksion apo person tjetër që përfshihet në blerjen, shitjen apo këmbimin e letrave me vlerë:

- a) nuk lejohet të zbatojë ndonjë plan, skemë apo makinacion për të mashtruar personin tjetër; ose
- b) nuk lejohet të angazhohet në ndonjë veprim, praktikë apo drejtim veprimtarie, i cili operon si mashtrues, apo ka të ngjarë të operojë si i tillë, në lidhje me personin tjetër.

Neni 53

Deklarata false apo mashtruese lidhur me shitjen e letrave me vlerë

Asnjë person nuk lejohet që drejtpërdrejt ose tërthorazi, me qëllim stimulimin e shitjes apo blerjes së letrave me vlerë të ndonjë shoqërie tregtare, të bëjë, me vetëdije të plotë, në lidhje me këto letra me vlerë apo me operacionet dhe veprimtarinë e shkuar ose të ardhshme të shoqërisë tregtare:

- a) ndonjë deklaratë false apo mashtruese, në lidhje me ndonjë fakt të rëndësishëm; ose
- b) ndonjë deklaratë, e cila për shkak të harresës ose mosparaqitjes së ndonjë fakti të rëndësishëm, është false apo mashtruese.

Neni 54

Detyrimi për zhdëmtim

1. Personi që është shpallur fajtor sipas këtij kreu, përveç detyrimit që ka për veprimin kriminal, është i detyruar të përgjigjet për dëmet e shkaktuara, kundrejt padisë së ngritur nga ndonjë person tjetër, i cili ka pësuar humbje financiare si pasojë e blerjes apo shitjes së letrave me vlerë në një çmim që është ndikuar nga veprimi apo transaksioni që është subjekt i krimit.

2. Pika 1 e këtij neni, nuk kufizon apo zvogëlon asnjë detyrim civil që një person mund të ketë në lidhje me ndonjë ligj tjetër.

KREU IX

MARRJA E PAKETËS KONTROLLUESE

(Ndryshuar titulli i Kreut me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Neni 55

Marrja e paketës kontrolluese

(Ndryshuar me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Në këtë kre “oferta për marrje të paketës kontrolluese” nënkupton një ofertë për të marrë paketën kontrolluese nga/ose në emër të një shoqërie tregtare (“ofruesi”) ose

- 1. të gjitha aksionet e një shoqërie tregtare tjetër (shoqëria tregtare e ofruar), të ndryshme nga aksionet, të cilët në datën e ofertës zotërohen nga ofruesi;
- 2. ato aksione në shoqërinë tregtare të ofruar që rezultojnë në marrjen e kontrollit efektiv

të shoqërisë tregtare nga ana e ofruesit.

Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, “marrja e kontrollit efektiv” nënkupton marrje të paketës kontrolluese të aksioneve në një shoqëri tregtare ofruese e cila, bashkë me aksionet, nëse ka, që zotëron aktualisht ofruesi ose një shoqëri tregtare tjetër që parashikohet nga neni 56 i këtij ligji, si e lidhur me ofruesin, ka të drejtën të ushtrojë ose të kontrollojë ushtrimin e jo më pak se 50 për qind të të drejtave përkatëse të aksioneve me të drejtë vote në shoqërinë tregtare ofruese.

Neni 56

Shoqëritë tregtare të lidhura

Një shoqëri tregtare është e lidhur kur:

- a) është shoqëri tregtare mbështetëse e një shoqërie tregtare tjetër;
- b) është filial i një shoqërie tregtare tjetër; ose
- c) është filial i një shoqërie tregtare mbështetëse të një shoqërie tregtare tjetër.

Neni 57

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

1. Autoriteti mund të përcaktojë rregulla lidhur me kryerjen dhe drejtimin e ofertave për marrje të paketës kontrolluese.

2. Kur Autoriteti ka përcaktuar rregulla sipas pikës 1 të këtij neni, asnjë person nuk duhet të bëjë apo ndjekë realizimin e një oferte për marrje të paketës kontrolluese përveçse kur është në përputhje me këto rregulla.

KREU X

INFORMIMI, INSPEKTIMI DHE HETIMI

(Shfuqizuar Kreu X, nenet 58-62 me ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006)

KREU XI

TË NDRYSHME

Neni 63

Shkeljet dhe gjokat

(Ndryshuar togfjalësh në shkronjën ‘a’ dhe ‘b’ me ligjin nr. 8745, datë 22.2.2001)

Një person i cili shkel ndonjë kusht të këtij ligji, është fajtor dhe dënohet me gjokë:

- a) në rastin e një personi i cili nuk është shoqëri tregtare, nga 30 mijë deri në 1 milionë lekë;
- b) në rastin e një shoqërie tregtare, nga 50 mijë deri në 5 milionë lekë.

Neni 64

Masat disiplinore kundrejt të licencuarve

(Shfuqizuar pikat 2, 3 dhe 4 me ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006)

1. Një i licencuar që shkel ndonjë kusht të këtij ligji, apo ndonjë rregull të përcaktuar në bazë të këtij ligji, bën shkelje disiplinore dhe është subjekt procedimi disiplinor nga Autoriteti pavarësisht nga ndonjë masë tjetër, qoftë civile ose penale, që mund të merret kundër të licencuarit në lidhje me të njëjtën sjellje.

2. Shfuqizuar.

3. Shfuqizuar.
4. Shfuqizuar.

Neni 65

Transferimet e letrave me vlerë

1. Pavarësisht nga kushtet e ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, Autoriteti mundet që në lidhje me letrat me vlerë të cilat janë të listuara apo të propozuara për t’u listuar, në bazë të rregullave, të përcaktojë një kusht për të lejuar evidentimin dhe transferimin e pronësisë mbi letrat me vlerë pa nevojën e ndonjë dokumenti me shkrim.

2. Rregullat e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni:

a) mund të vendosin kushte për procedurat e regjistrimit dhe transferimin e të drejtave mbi letrat me vlerë;

b) mund të vendosin kushte për rregullimin e këtyre procedurave dhe personave që janë përgjegjës për apo të përfshirë në operacionet e tyre;

c) përmbajnë disa masa sigurie të përcaktuara si të përshtatshme për mbrojtjen e investitorëve dhe për të siguruar moskufizimin, shtrembërimin apo parandalimin e konkurrencës;

ç) mund të përfshijnë kushte të tjera shtesë, të rastësishme ose të përkohshme, ashtu siç mund të gjykohen si të nevojshme ose të këshillueshme.

3. Në këtë nen, me letra me vlerë “të listuara” do të nënkuptohen letrat me vlerë të cilat janë të kuotuar, të listuara apo të pranuar për t’u tregtuar në një treg zyrtar të letrave me vlerë.

Neni 66

Rregullat

1. Autoriteti mund të vendosë rregulla për apo në lidhje me ndonjë çështje që sipas këtij ligji kërkohet apo lejohet të përshkruhet, apo që është e nevojshme ose e përshtatshme të përshkruhet për siguruar zbatueshmërinë e këtij ligji.

2. Pa paragjykuar pikën 1 të këtij neni, Autoriteti mund të vendosë rregulla që kërkojnë licencimin e agjencive të pastrimit të llogarive, depozituesve të letrave me vlerë dhe personave që kryejnë regjistrimin e letrave me vlerë apo shërbimet e ruajtjes së tyre.

Neni 67

Njoftimet udhëzuese

(Shfuqizuar me ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006)

Dispozita Kalimtare

(Parashikuar në ligjin nr. 8745, datë datë 22.2.2001)

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, që brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të marrin masat e nevojshme për transformimin e Bursës së Tiranës në shoqëri anonime.

Deri në transformimin e Bursës së Tiranës në shoqëri anonime, sipas këtij neni, ajo do të qëndrojë në varësi të Bankës së Shqipërisë

Neni 68

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 1416, datë 20.3.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**